



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 477, datë 13.09.2023**

**PËR**

**KONFIRMIMIN SI NDIHMËSMAGJISTRAT NË GJYKATËN E LARTË TË  
GJYQTARES {...} DHE ZGJATJEN E MANDATIT TË KOMANDIMIT  
ME 1 (NJË) VIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, dhe 56, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 34 pika 4 e Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 343 datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, dërguar me Shkresën nr.3986 prot., datë 18.07.2023, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë gjyqtaren {...}, duke vendosur zgjatjen e mandatit të komandimit me një vit.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 20.10.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**